



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.268/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Naser Canolli, për shkak tentimit të votimit të dyfishtë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa **Anr.268/2017** e datës 12.06.2017, paraqitur kundër Naser Canolli, për shkak të shkeljes së supozuar-tentimit të votimit të dyfishtë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se aktivisti i tyre gjatë ditës së votimit ka vërejtur se në shkollë fillore “Ahmet Gashi”, në Prishtinë, Naser Canolli-Drejtori i Termokosit ka tentuar që të votoj edhe një herë. Më këtë rast pretendohet se është bërë shkelje e dispozitë së nenit 216 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ku kemi keqpërdorim të drejtës së votimit, votim të dyfishtë.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenin 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se aktivisti i tyre ditën e votimit në shkollën fillore “Ahmet Gashi”, në Prishtinë, ka vërejtur se Naser Canolli-Drejtori i Termokosit ka tentuar që të votoj edhe një herë.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së. Pretendimet ankimore të ankuesit nuk gjejnë mbështetje ligjore për faktin se nuk janë materializuar me prova përkatëse materiale.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.268/2017 më datën 13.06.2017

Kryesuesi i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*